

Obrinje, komuna e Glogocit/Glogovac)

Luljeta (Sadri) Deliu

(1971, shqiptare nga Obria e Epërme/Gornje Obrinje, komuna e Glogocit/Glogovac, tre fëmijë)

Mihane (Arif) Deliu

(17.11.1973, shqiptare nga Obria e Epërme/Gornje Obrinje, komuna e Glogocit/Glogovac, një fëmijë)

Jeton (Imer) Deliu

(20.09.1988, shqiptar nga Obria e Epërme/Gornje Obrinje, komuna e Glogocit/Glogovac, nxënës)

Gentiana (Hajriz) Deliu

(7.05.1990, shqiptare nga Obria e Epërme/Gornje Obrinje, komuna e Glogocit/Glogovac)

Donjeta (Hajriz) Deliu

(12.08.1991, shqiptare nga Obria e Epërme/Gornje Obrinje, komuna e Glogocit/Glogovac)

Menduhije (Imer) Deliu

(16.05.1994, shqiptare nga Obria e Epërme/Gornje Obrinje, komuna e Glogocit/Glogovac)

Valmir (Adem) Deliu

(21.09.1996, shqiptare nga Obria e Epërme/Gornje Obrinje, komuna e Glogocit/Glogovac)

Në datën **26.09.1999**, kur forcat serbe depërtuan në fshatin **Obri e Epërme/Gornje Obrinje**, 18 anëtarë të familjes Deliu gjendeshin të strehuar në pyllin përmbi fshatin e tyre, në vendin e quajtur *Zabeli i Rrënjëve/Koreniti šumarak*. Aty ishin: Pajaziti i moshuar me bashkëshorten Hamiden dhe motrën e saj Have Elshanin, e cila ka ardhur si mysafire nga fshati Gllobar/Globare; e reja e tyre Lumnije [bashkëshortja e Imerit] me vajzën Menduhijen, 4 vjeçe, djemtë Jetonin dhe Albertin, si dhe foshnjën Diturijen; e reja e tyre Mihane [bashkëshortja e Ademit] me djalin Valmirin, 2 vjeç; si dhe e reja Luljete [bashkëshortja e Enverit], e cila ishte në muajin e nëntë të shtatzënisë, dhe fëmijët e saj Besniku, Liridoni dhe Arlindi. Së bashku me ta ishin edhe Ali Deliu i moshuar dhe Zahidja, e reja e djalit të tij Hajrizit [të shikohet regjistrimi], e cila ishte me Donjetën, 5 vjeçe dhe Gentianen, 7 vjeçe [fëmijët e Hajrizit nga martesë e parë].

Aliu qëndronte i ulur paksa më larg shatorit, kur papritmas erdhën pjesëtarët e forcave serbe. Mal Asllani, pjesëtar i UÇK-së, i cili qëlloi të ishte afro 200 - 300 metra larg tendës së familjes Deliu, ishte dëshmitar kur ushtarët dhe policët së pari e morën me vete Aliun dhe, më pas, vazhduan tutje drejt tendës së Deliajve. Pastaj, Aliu dëgjoi britmën dhe sharjet që ushtarët dhe policët u drejtonin grave, fëmijëve dhe pleqve. Ka pasuar tutje klithma e grave dhe të fëmijëve. Mali, aty për aty, nuk ka mundur të kuptonte çfarë ka ndodhur me familjen Deliu. Dy ditë më vonë, Imer Deliu i ka gjetur trupat e masakruar të Pajazitit, Hamides, Haves, Lumnijes, Menduhijes, Jetonit, Mihanës, Valmirit, Zahides, Donjetës, Gentianës dhe Luljetës. Edhe pse vetëm foshnje, Diturija, e cila ishte në gjirin e Lumnijes, ka mbi-jetuar çuditërisht. Për Albertin, Besnikun, Liridonin dhe Arlindin nuk dihej asgjë, përderisa disa bashkëfshatarë nuk i treguan Imerit se fëmijët ishin mirë e shëndosh dhe se gjendeshin në *Mëhallën e Hysenajve*, ku për ta po kujdesej Shehide Hysenaj e moshuar [të shikohet regjistrimi vijues]. Shehidja i ka treguar Imerit më vonë se ushtarët serbë, në uniformë të gjelbra dhe kaltra, një ditë më herët, i sollën fëmijët tek ajo dhe i urdhëruan që të kujdesej për ata.

Në datën 30.09.1998, Hava, Pajaziti, Jetoni, Hamidja, Luljeta, Valmiri, Lumnija, Menduhija, Mihanja, Donjeta, Gentiana dhe Zahidja u varrosën në fushën e Imerit, jo larg shtëpisë së tij. Një vjet më vonë, mbetjet e tyre mortore janë rivarrosur në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Obri-në e Epërme/Gornje Obrinje

Burimet: deklarata, R.D, FDH-8882; deklarata I.D, FDH-8883; deklarata I.D, FDH-16499; deklarata I.D, FDH-8886; deklarata M.A, FDH-8880; FHP, *Haški tribunal, Šuđenje Slobodanu Miloševiću*, Beograd, 2006, VIII, 25, 26; KMDLNJ, *Buletini*, num. 9, tetor - dhjetor 1998, 117, FDH-23857; HRW, *Po narendnju...*, 80, 216 i 582, FDH-18976; ICTY, IT-05-87 (M. Milutinović dhe të tjerë), EX.5D00755, FDH-33256; ICTY, IT-05-87 (M. Milutinović dhe të tjerë), EX.5D00756, FDH-33269; ICTY, IT-05-87 (M. Milutinović dhe të tjerë), EX.4D00403, FDH-33267; ICTY, IT-05-87 (M. Milutinović dhe të tjerë), EX.P01440, FDH-33047; ICTY, IT-05-87 (M. Milutinović dhe të tjerë), EX.6D00197,